



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

## GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:026676  
Datë: 12.03.2024  
Numri i dokumentit: 05441853

**A.C.nr.4080/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, nga Gjyqtari individual Bujar Muzaqi, në çështjen përmbarimore të kreditores A.B. nga Komuna Gjakovë, të cilën e përfaqëson me autorizim F.S., avokat me seli në Komuna Gjilan, kundër debitorit Qendra e Shëndetit Mendor – Shërbimi i Integritimit në Bashkësi, me seli në Komuna Gjakovë, në çështjen përmbarimore, për përmbarimin e vendimit administrativ të inspektoratit të punës, për pagesën e pagave jubilarë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.648/20 datë 07.06.2022, me datë 12.03.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET e pathemeltë** ankesa e debitorit Qendra e Shëndetit Mendor – Shërbimi i Integritimit në Bashkësi, me seli në Komuna Gjakovë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.648/20 datë 07.06.2022, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.648/20 datë 07.06.2022, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

*“... I. REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorit Qendra e Shëndetit Mendor – Shërbimi i Integritimit në Bashkësi - Gjakovë, i paraqitur kundër urdhrit përmbarimor, P.nr.1240/20 i datës 27.11.2020, i caktuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat G.Gj. për territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë.*”

*II. Ankesa e paraqitur nuk e ndal ekzekutimin e vendimit...”.*

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar debitori, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, që të hudhet poshtë aktvendimi PPP.nr.648/20 datë 07.06.2022, dhe të aprovohet si e bazuar ankesa.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur kreditori me propozim që të refuzohet ankesa e debitorit si e pabazuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

**- Ankesa është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës konstatohet se kreditori A.B. nga Komuna Gjakovë, ka paraqitur propozim për përmbaremore te Përmbareuesi Privat G.Gj., kundër debitorit Qendra e Shëndetit Mendor – Shërbimi i Integritimit në Bashkësi, me seli në Komuna Gjakovë, në bazë të dokumentit përmbareues – vendimit të Inspektoratit të Punës nr. 372/2020, datë 08.05.2020, i cili është bërë i formës së prerë me datë 02.09.2020, dhe i ekzekutueshëm me datë 02.09.2020.

Përmbareuesi Privat G.Gj., e ka lejuar propozimin për përmbaremore me urdhër P.nr.1240/20 datë 27.11.2020, ndaj të cilit urdhër debitori në afat ligjor ka paraqitur prapësim me datë 07.12.2020, duke theksuar se procedura përmbaremore është iniciuar në kundërshtim me nenin 71 paragrafi 1, pika 1, nënpika 1.1 të LPP-së, për shkak të Përmbareuesi Privat ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditorja me datë 18.12.2020, duke theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim ngase Përmbareuesi Privat me rastin e lejimit të urdhrorit për përmbaremore është mbështetur në vendimin Nr. 372/2020, datë 08.05.2020, i cili vendim është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 02.09.2020.

Gjykata e shkallës së parë me datë 07.06.2022, ka marrë aktvendim PPP.nr.648/20 datë 07.06.2022, me të cilin ka vendosur që ta refuzojë në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të Aktvendimit të atakuar ndër të tjera ka arsyetuar se: *“... Nga shkresat e lëndës rezulton se caktimi i përmbaremore është bërë duke u bazuar në Vendimin e Inspektoratit të Punës nr. 372/2020, datë 08.05.2020, me të cilin vendim është detyruar që debitori t’ia paguaj kreditores borxhin në shumë prej 465.58€ në emër të shpërblimit jubilar për një (1) paga jubilarë. Gjykata ka vlerësuar*

*Vendimin e Inspektoratit të Punës Nr.372/2020, datë 08.05.2020, i ekzekutueshëm nga data 02.09.2020, në bazë të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe vlerëson së ky vendim i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 21, 22 par.1 pika 1.2, 23, 24 paragrafi 3 dhe 27 të LPP-së, për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim...”.*

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i kuartë, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullte dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j), (k), dhe (m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

Në nenin 21 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, ndër të tjera thuhet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues dhe dokumentit të besueshëm...”*. Duke marrë parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për ekzekutim, në bazë të dokumentit përmbarues, organi përmbarues e cakton përmbarimin vetëm në bazë të titullit përmbarues sipas nenit 22 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, e në rastin konkret titull përmbarues është Vendimi i Inspektoratit të Punës nr. 372/2020, datë 08.05.2020, i cili është bërë i formës së prerë me datë 02.09.2020, dhe i ekzekutueshëm me datë 02.09.2020.

Në nenin 22 pika 1.2 të Ligjit nr. 04/L-193 për Procedurën Përmbarimore ndër të tjera thuhet se: *“...dokumentet përmbaruese janë vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia);...”*, ndërsa në nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit nr.04/L-193 për Procedurën Përmbarimore ndër të tjera thuhet se: *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike...”*, e që në rastin konkret kemi të bëjmë me Vendim administrativ siç përcaktohet me dispozita ligjore.

Sa i përket pretendimit ankimor të debitorit se nuk ka pasur mundësi të bëjë pagesën për pagën jubilarë, për shkak se nuk ka mundësi që në skemën e saj buxhetore të planifikojë linjë të veçantë buxhetore për këtë lloj kompensimi, pasi që Qeveria nuk ka ndarë buxhet për implementimin e kësaj kategorie, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë, për faktin se ky pretendim nuk mund të jetë bazë për mos pagesën e shumës së përmendur në titullin përmbarues, andaj dhe ky pretendim është

i paqëndrueshëm dhe nuk ka pasur ndikim në vendosjen ndryshe nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të debitorit, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktvendimi atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbare, në të cilin nen ndër të tjera thuhet se: *“Në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, e lidhur me nenin 17, të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbare, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**A.C.nr.4080/2022 datë 12.03.2024**

**Gjyqtari,**  
**Bujar Muzaqi**